

URDHËR
Nr. 179, datë 6.11.2017

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimit nr. 315, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e dhënies së autorizimit, për përdorimin civil të lëndëve plasëse”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Enis Aliko, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, për nënshkrimin e autorizimeve për personat juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, për përdorimin civil të lëndëve plasëse.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 315, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e dhënies së autorizimit, për përdorimin civil të lëndëve plasëse”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjijnuri